



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 80, datë 28.04.2023**

**PËR**  
**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STRUKTURËS AKSIONARE TË SHOQËRISË**  
**“EURO BROKER” SH.A., DHE EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e ndryshimit të strukturës aksionare të shoqërisë “Euro Broker” sh.a., si rezultat i shitjes së aksioneve nga aksionari z. Mati Pepa te aksionari i ri zj. Ejnxh Pepa, si më poshtë:**

<b>Aksionarët</b>	<b>Përqindja e pjesëmarrjes</b>	<b>Numri i aksioneve</b>	<b>Vlera në Lekë</b>
Altin Sinani	51 %	1 785	1 785 000
Ejnxh Pepa	24 %	840	840 000
Nereida Bujupi	15 %	525	525 000
Bashkim Kryeziu	10 %	350	350 000
<b>Totali</b>	<b>100 %</b>	<b>3 500</b>	<b>3 500 000</b>

- 2. Miratimin e emërimit të z. Mati Pepa, si Administrator i shoqërisë “Euro Broker” sh.a.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**